

## **Termet e Referencës: Ekspert për Protokollin e Monitorimit për Pyjet me Dushk dhe Bush**

### **1. Hyrje**

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, përmes Grantit PONT në Peizazhin e Mbrojtur Ujor/Tokësor të Liqenit të Pogradecit (PA\_025), duke ndjekur planin operacional të dakordësuar për këtë zonë të mbrojtur, është e angazhuar në monitorimin dhe ruajtjen e specieve treguese si një komponent kyç i menaxhimit të përgjithshëm të zonës së mbrojtur së bashku me habitatet kryesore. Për të siguruar efektivitetin e përpjekjeve tona për ruajtje, ne po kërkojmë një ekspert me përvojë për të kryer një studim në lidhje me "Protokollin e Monitorimit për Pyjet me Dushk dhe Bush".

### **2. Objektivat**

Objektivat kryesore të angazhimit të ekspertit janë si më poshtë:

a. Të prodhojë një raport mbi Protokollin e Monitorimit për Pyjet me Dushk dhe Bush.

### **3. Qllimi**

Eksperti do të jetë përgjegjës për prodhimin e një raporti mbi Protokollin e Monitorimit për Pyjet me Dushk dhe Bush, që do të ndihmojë AdZM-nw e Korçës në zbatimin e protokollit të monitorimit të habitatit.

### **4. Kohwzgjatja**

Konsulenca pritet të fillojë më 15 korrik dhe të përfundojë më 15 shtator. Fokusi i detyrës do të jetë Peizazhi i Mbrojtur Ujor/Tokësor i Liqenit të Pogradecit.

### **5. Raportimi**

Eksperti do të dorëzojë një raport tek Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura së bashku me rekomandimet.

### **6. Kualifikimet**

Kandidati duhet të ketë:

a. 10 vite përvojë në fushën e ekspertizës së biodiversitetit

b. Ekspertizë të dëshmuar në përbërjen e habitatit dhe specieve të Peizazhit të Mbrojtur Ujor/Tokësor të Liqenit të Pogradecit

c. Njohuri me kontekstin ekologjik të zonës së projektit.

## **7. Buxheti**

Buxheti për konsulencën referohet linjave të buxhetit:

- Aktiviteti Nr. 2.5 "Protokoll Monitorimi për Pyjet me Dushk dhe Bush"

Duke bërë vlerën totale të kësaj konsulence 1300 Euro duke përfshirë 15% të taksave.

## **8. Procesi i Aplikimit dhe Afati**

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë një CV deri më 7 korrik në adresën [info@akzm.gov.al](mailto:info@akzm.gov.al)